

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtareve Kujtim Pasuli - kryetar i kolegjit dhe Nenad Llaziq e Makifete Saliuka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.K., nga Mitrovica, të cilin e përfaqëson i autorizuari av. Z.A., nga Mitrovica, kundër të paditurve A., I., R., E., N., Ah., Av., të gjithë nga fshati ..., Komuna Istog, të cilët i përfaqëson i autorizuari av. S.B., nga Peja, për shkak të kthimit të borxhit, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditurve të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, C.nr.207/11 të datës 05.04.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **22.12.2016**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.PRANOHET si e bazuar ankesa përkitazi me lartësinë e kamatës së gjykuar me aktgjykimin e gjykatës themelore në Pejë - Dega në Istog, C.nr. 207/11, të datës 05.04.2013, ashtu që në këtë pjesë ky aktgjykim **NDRYSHOHET** dhe detyrohen të paditurit që shumën prej 100.000€, t'ia kthejnë paditësit me kamatë të cilat i paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursime me afat mbi një vit dhe pa destinim të caktuar duke filluar që nga data 30.09.2005, e gjerë në pagesën definitive.

II. Në pjesën tjetër ankesa e të autorizuarit të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit në fjalë **REFUZOHET** si e pabazuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e goditur, nën I. të dispozitivit janë obliguar të paditurit, që në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të aktgjykimit t'ia kthejnë- paguajnë paditësit shumën prej 100.000,00 €, e të cilën shumë nga paditësi e kishin marr hua, me kamatë vjetore prej 3.5%, duke filluar që nga data 30.09.2005 e deri në përmbushjen e tërësishme. Nën II të dispozitivit janë obliguar të paditurit që paditësit t'ia kompensojnë të gjitha shpenzimet kontestimore në lartësi prej 620,62 €, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i paditurve për shkak të:

- Shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore,
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e atakuar, ta prish dhe lëndën t'ia kthej në rigjykim gjykatës së shkallës së parë, ose së paku pjesërisht atë ta ndryshoj dhe ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i autorizuari i paditësit, me propozim që të refuzohet në tërësi si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditurve, ndërsa aktgjykimi i goditur të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, duke vepruar në kuptim të nenit 194 të Ligjit të procedurës kontestimore, ka vlerësuar aktgjykimin e goditur në kuadër të kufijve të arsyeve të theksuara në ankesë, duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 e 2 si dhe zbatimit të drejtë të së drejtës materiale dhe gjeti se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurit t'ia kthejnë huan në shumë prej 100.000,00 €, me kamatë si dhe duke kërkuar edhe shpenzimet e procedurës. Ka theksuar se sipas kontratës mbi huan të dt. 28.05.2004, ka dhënë hua të paditurve shumë e lartcekur me afat kthimi në 2 këste dhe atë shumë prej 50.000,00 € deri më dt. 31.03.2005 dhe këstin e dytë me dt. 30.09.2005. Ka theksuar se ka kërkuar kthimin e huas nga të paditurit por të paditurit nuk kanë shprehur dëshirën që ta kthejnë këtë hua.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit dhe vlerësimit të provave ka marr aktgjykim me të cilin ka obliguar të paditurit që ta kthejnë paditësit huan në shumë prej 100.000,00 €, me kamatë 3.5%, nga data 30.09.2005 e deri në pagesën definitive si dhe ka detyruar që ta paguajnë edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 620,62€. Një vendim të tillë gjykata e shkallës së parë e merr pasi që ka vërtetuar se paditësi si huadhënës dhe të paditurit si huamarrës kanë lidhur kontratën mbi huan, e të cilën e kanë vërtetuar edhe në gjykatë, dhe se në këtë kontratë nuk është paraparë se është lidhur me ndonjë kamatë apo fajde, por me dëshirë vullnet dhe pajtueshmërinë e plotë, duke mos qenë të kërcënuar në lajthim dhe për objektin e lejueshëm. Lidhur me shumë e huadhënies të njëjtën e ka vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit M.M., dhe T.K., ndërsa dëshmitari B.M. ka sqaruar në mënyrë të qartë se nuk ka bërë as një pagesë në emër të paditurve por ka paguar borxhin e vet. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar sipas vërejtjeve gjykatës së instancës më të lartë se nuk kishte dijeni për lidhjen e kontratës së shitblerjes në mes të ndjerit I.K. dhe tani të paditurve. Përfundimisht konstaton se kontrata mbi huan është lidhur në bazë të autonomisë të vullnetit të shprehur të lirë e sipas nenit 2 pika 1 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve, dhe disponimi dhe vullneti i lirë i palëve nuk ka qenë në kundërshtim me nenin 3.3 të LPK.

Pran një gjendje të tillë të çështjes Gjykata e apelit e Kosovës, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare lidhur me aplikim e gabuar të së drejtës materiale gjeti se kamata e aprovuar është marr në kundërshtim me nenin 277 të LMD-së, e kjo për faktin se kamata nuk ka mundur të i caktohet paditësit në lartësi prej 3.5%, dhe për këtë arsye kjo gjykatë me aplikim e dispozitës së lartpërmendur ligjore vendimin lidhur me kamatën e mori në tersi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e ndryshuar të njëjtin.

Në pjesën refuzuese të ankesës, kjo gjykatë ka gjetur se aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare të parapara me nenin 194 e lidhur me nenin 182 par.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-ës, e as në ato në të cilat thirret ankesa nga neni 182 par. 1 dhe 182 par.2 pika n). Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftuara për faktet vendimtare dhe këto arsye lidhur me faktet vendimtare nuk janë kontradiktore dhe as që ka kundërshtim midis asaj që thuhet në dispozitiv dhe arsyetim të aktgjykimit. Provat e administruara nga ana e gjykatës janë vlerësuar veç e veç dhe në tërësi e në kuptim të nenit 8 të LPK. Kjo gjykatë gjen se nuk qëndrojnë pretendimi ankimor se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike, sepse gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar të gjitha faktet vendimtare për marrjen e një vendim të drejtë dhe të ligjshëm dhe për këto fakte ka dhënë arsye të mjaftuara, e të cilat arsye në tërësi i pranon edhe kjo gjykatë si të drejta. Kjo gjykatë vlerësoj se gjykata e shkallës së parë me vërtetim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, kur ka detyruar të paditurit që në afat prej 15 ditësh t'ia kthejnë-paguajnë shumën prej 100.000€, e të cilën shumë nga paditësi e kishin marr hua. **Kjo për faktin se në kontratën mbi huan nuk është përcaktuar asnjë kamatë, e për të qenë kontratë me fajde duhet të jetë kontraktuar kamata e lart, përkatësisht tejet e lart, e cila paraqet rastin tipik të kontratës me fajde. Në fakt, kontrata që gjendet në shkresat e lëndës nuk i plotëson kushtet e kërkuara për tu konsideruar si kontratë me fajde, sepse nuk ekziston disproporcioni i dukshëm ndërmjet asaj që njëra anë merr dhe ajo që jep, sipas kontratës, dhe ky disproporcion të jetë pranuar nga nevoja, mendjelehtësia apo nga mungesa e përvojës. Njëherit, nga shkresat e lëndës nuk është vërtetuar që kontraktuesi ka ditur se pala tjetër kontraktuese ka nevojë, se është mendjelehtë apo nuk ka përvojë. Me asnjë provë nuk është vërtetuar se paditësi si palë kontraktuese ka shfrytëzuar rrethanat e papërshtatshme që të nxjerr për vete fitimin e pa masë të pasurisë. Pra, nga të cekuar rezulton se nuk është provuar se janë plotësuar komulativisht kushtet e kërkuara për të qenë një kontratë me fajde. Në fakt, palët janë pajtuar për elementet qenësore të kontratës dhe kanë shprehur lirshëm vullnetin e tyre, duke vërtetuar të njëjtën pran gjykatës kompetente. Duke u nisur edhe nga neni 319 të LPK-së, me të cilën është paraparë që secila nga palët ndërgjyqëse kanë për detyrë të provojnë faktet mbi të cilat i bazoj pretendimet e veta, atëherë kjo gjykatë vlerëson se të paditurit nuk kanë mundur të provojnë ekzistimin e disproporcionit të dukshëm, nevojën e tyre ekstreme, mendjelehtësinë si dhe mungesën e përvojës si dhe që pala tjetër kontraktuese ka ditur ose është dashur ta dijë se këta kanë nevojë, se janë mendjelehtë dhe nuk kanë përvojë, e as që kanë mundur të provojnë se pala kontraktuese në këtë rast paditësi ka shfrytëzuar rrethanat e papërshtatshme për të nxjerr për vete fitimin e pamasë të pasurisë.**

Prandaj, nga të paraqiturat është vendosur si në dispozitivë e në kuptim të nenit 195 par.1 pika d) dhe e) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1570/2013 të datës 22.12.2016

Kryetar i kolegjit – gjyqtari